

Seancës Plenare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Këshilli për Legjislacionin

Dokument parlamentar

Nr _____ Prot

Tiranë, më ___/___/2024

Në vëmendje të:

Znj. Elisa Spiropali
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Këshillit të Legjislacionit

Lënda: *Mendimi i anëtarëve të shumicës parlamentare në vijim të urdhërit nr. 54, datë 08.08.2024 të Kryetares së Kuvendit dhe mbledhjes datë 27.08.2024 të Këshillit të Legjislacionit për zbatimin e vendimit nr.55, datë 10.07.2024 të Gjykatës Kushtetuese (Raporti)*

Në përputhje me nenin 75 të Kushtetutës dhe nenet 14 dhe 87 të Rregullores së Kuvendit dhe në vijim të urdhërit të Kryetares së Kuvendit nr.54, datë 08.08.2024, në datë 27.08.2024 u zhvillua mbledhja e Këshillit të Legjislacionit me rend dite “*Shqyrtimin e vendimit nr. 55, datë 10.07.2024 të Gjykatës Kushtetuese*”. Pas diskutimeve në këtë mbledhje, anëtarët e shumicës dhe pakicës parlamentare në këtë Këshill, çmuan të paraqesin opinionet në raporte të veçanta, ndërsa u dakordësuan të rekomandojnë se çështja duhet të kalojë në seancën plenare më të afërt të Kuvendit për të vendosur për dërgimin e çështjes së papajtueshmërisë së mandatit të deputetes Olta Xhaçka në Gjykatën Kushtetuese. Ky dokument përfaqëson mendimin e shumicës parlamentare në Këshillin e Legjislacionit.

I. BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE

Neni 132 i Kushtetutës

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim.

- 2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë që vendimi i saj, me të cilin ka shqyrtuar aktin, të fillojë efektet në një datë tjetër.*
- 3. Mendimi i pakicës publikohet bashkë me vendimin përfundimtar.*

Neni 131 i Kushtetutës

- 1. Gjykata Kushtetuese vendos për: e) çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve, të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre.*

Neni 134 i Kushtetutës

- 1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: c) jo më pak se një të pestës së deputetëve;*

Neni 70 i Kushtetutës

- 1. Deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues.*
- 2. Deputetët nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht asnjë detyrë tjetër shtetërore, përveç asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave. Rastet e tjera të papajtueshmërisë caktohen me ligj.*
- 3. Deputetët nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre.*
- 4. Për çdo shkelje të paragrafit 3 të këtij neni, me mocion të Kryetarit të Kuvendit ose të një së dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë.*

Neni 73 i Kushtetutës

- 1. Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e shpifjes.*

Neni 75 i Kushtetutës

- 2. Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve.*

Neni 78 i Kushtetutës

- 2. Mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas rregullores, nuk sjellin asnjë pasojë.*

Neni 87 i Rregullores së Kuvendit

- 1. Kryetari i Kuvendit i përcjell Këshillit për Legjislacionin vendimet e Gjykatës Kushtetuese për:
a) vlerësimin e kushtetutshmërisë së legjislacionit që ka nismëtar deputetin/deputetët;
b) interpretimin përfundimtar të Kushtetutës;
c) zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës kur Kuvendi është palë;*

- c) shkarkimin e funksionarëve kushtetues, të cilët zgjidhen nga Kuvendi;
d) rastet kur kërkesa në Gjykatë Kushtetuese është paraqitur nga jo më pak se 1/5 e deputetëve.

2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, që kanë efekt në legjislacion, merren në shqyrtim nga Këshilli për Legjislacionin brenda 30 ditëve pas botimit të tyre në Fletoren Zyrtare.
3. Këshilli analizon dhe diskuton, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Rregullore, efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, për çështjet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Këshilli harton një raport dhe i paraqet atë Kryetarit të Kuvendit.
4. Raporti i Këshillit, kur çmohet e nevojshme, mund t'i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, Këshillit të Ministrave dhe Presidentit të Republikës.
5. Kur nevojitet marrja e nismës ligjvënëse për plotësime ose ndryshime në legjislacion, Këshilli i paraqet rekomandimet e nevojshme komisionit përgjegjës dhe nismëtarit, ose ndërmerr vetë nismën ligjvënëse.

Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, me ndryshime.

II. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Në datën 20.06.2022, 14 deputetë në bazë të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës së Shqipërisë, i janë drejtuar Kuvendit me mocion “Për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes së Kuvendit, Olta Xhaçka”, duke pretenduar ushtrimin nga kjo e fundit të funksionit të deputetes në kundërshtim me nenin 70, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës (mocioni i parë).
2. Me shkresën nr. 2402, datë 01.07.2022, një grup tjetër, i përbërë nga 15 deputetë po të pakicës parlamentare, kanë depozituar në Kuvend një kërkesë për mocion për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka, duke pretenduar ushtrimin nga kjo e fundit të funksionit të deputetes në kundërshtim me nenin 70, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës (mocioni i dytë). Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin bashkoi kërkesat dhe kreu shqyrtimin e tyre në të njëjtën procedurë.
3. Në raportin e saj pakica parlamentare ka konkluduar se mocioni i paraqitur plotësonte kriteret kushtetuese dhe Kuvendi kishte detyrimin për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), për sa kohë ky mocion kishte të bënte me kryerjen e veprimtarive fitimprurëse që buronin nga pasuria e shtetit.
4. Shumica parlamentare në raportin e saj ka konkluduar se nga aktet e depozituara prej kërkuesve të të dy mocioneve nuk rezultonte që për deputeten Olta Xhaçka dhe bashkëshortin e saj të plotësoheshin kriteret kushtetuese të parashikuara në pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës (kryerja nga deputeti e veprimtarisë fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit dhe e pushtetit vendor dhe përfitimi i pasurive të këtyre të fundit) për vënien në lëvizje të Gjykatës sipas përcaktimeve të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës. Në kushtet kur ndërmjet përfaqësuesve të pakicës parlamentare dhe asaj të shumicës nuk është rënë dakord për dërgimin e çështjes në Gjykatë, raportet i kanë kaluar për shqyrtim seancës plenare të Kuvendit.

5. Me vendimin nr. 83, datë 17.11.2022, Kuvendi ka vendosur: “Mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka” (vendimi nr. 83/2022), ndërsa me vendimin nr. 84, datë 17.11.2022, Kuvendi ka vendosur: “Miratimin e raportit të shumicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka” (vendimi nr. 84/2022).

6. Duke mos qenë dakort me këto vendimmarrje, në datën 18.11.2022, një grup tjetër prej 28 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve, ka vënë në lëvizje Gjykatën për shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën, të vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit, si dhe konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka. Në lidhje me këtë kërkesë, Kolegji i Gjykatës në datën 07.12.2022 vendosi kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit në datën 16.12.2022 vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

7. Gjithashtu, me kërkesën e datës 18.11.2022, një grup prej 14 deputetësh të Kuvendit, një e dhjeta e deputetëve, në kuptim të pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës të krijuar mes tij dhe Kuvendit, të shkaktuar nga vendimmarrjet nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit, si dhe shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën, të këtyre akteve, të cilat janë bërë shkak për lindjen e këtij konflikti me natyrë kushtetuese. Për këtë kërkesë, në datën 05.12.2022 Kolegji i Gjykatës Kushtetuese vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Mbledhja e Gjyqtarëve në datën 16.12.2022 vendosi kalimin e të dyja çështjeve për shqyrtim në seancë plenare publike, që u caktua datë 18.01.2023.

8. Gjykata Kushtetuese për kërkesën e 14 *deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë (jo më pak se 1/10 e deputetëve)*, me vendimin nr.1, datë 23.1.2023, **ka vendosur:**

1. *Pranimin e kërkesës.*

2. *Zgjidhjen e konfliktit/mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10-ta e deputetëve.*

3. *Shfuqizimin e vendimeve nr. 83, datë 17.11.2022 “Për mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka” dhe nr. 84, datë 17.11.2022 “Për miratimin e raportit të shumicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka” të Kuvendit të Shqipërisë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.*

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare

9. Gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se Kuvendi nuk mund të vlerësojë në themel nëse deputetja në fjalë, përmes bashkëshortit të saj, ka kryer veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe nëse ka fituar pasuri të këtyre, **si dhe nëse veprimet/mosveprimet e deputetes, përmes bashkëshortit të saj, përbëjnë shkelje të pikës 2 ose të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës.** Me fjalë të tjera, sipas Gjykatës, çështja e vlerësimit të papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes, e cila nëpërmjet bashkëshortit mund të ketë ushtruar veprimtari

fitimprurëse që burojnë nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe të ketë fituar pasuri të këtyre, referuar fakteve, **nuk i takon vlerësimin të Kuvendit**, por vlerësimin të kësaj Gjykate, pasi ato (faktet) kërkojnë shqyrtimin në themel, **në mënyrë që të mund të përcaktohet nëse duhet të klasifikohen në parashikimet e nenit 70, pika 2 ose nenit 70, pika 3, të Kushtetutës.**

10. Gjithashtu, Gjykata arsyeton se: ...55 Gjykata rithekson se në zbatim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit ka të drejtë të paraqesë mocion për konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetit, ndërsa vendimmarrja e Kuvendit është e domosdoshme me qëllim vënien në lëvizje të kësaj Gjykate për t'u shprehur për themelin e çështjes, për sa kohë që pa një vendim të këtij organi Gjykata nuk mund të shqyrtojë kërkesa të tilla.

56. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Kuvendi duhet të kishte pranuar mocionin e kërkuarit dhe të dërgonte çështjen për shqyrtim në këtë Gjykatë, në mënyrë që aspektet e pretenduara si papajtueshmëri të mandatit të deputetes Olta Xhaçka t'i nënshtroheshin vlerësimin kushtetues, pasi gjatë gjykimit kushtetues nuk u verifikua ndonjë pengesë juridiko-formale që mocioni të pengohej nga Kuvendi.

11. Ndërsa në lidhje me kërkesën e 1/5 të deputetëve me vendimin e saj nr.2, datë 23.1.2023, Gjykata Kushtetuese vendosi:

1. Pushimin e gjykimit të çështjes.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Duke konstatuar se çështja kishte në objektin e saj dy kërtime, në këtë vendim, Gjykata arsyetoi, ndër të tjera se: Gjykata vlerëson se nuk ka juridiksion për të shqyrtuar kërkesat në lidhje me shkeljen e ndalimeve të nenit 70, pika 2 të Kushtetutës dhe gjykimi duhet të pushohet.

Ndërsa për kërkesat për shkelje të ndalimeve sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, Gjykata konstaton se ai ka marrë përgjigje në vendimin e saj nr. 1/2023. Si më lart u parashtrua, në këtë vendim, në koherencë me jurisprudencën e saj, Gjykata ka ritheksuar se në zbatim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit ka të drejtë të paraqesë mocion për konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetit, ndërsa vendimmarrja e Kuvendit është e domosdoshme me qëllim vënien në lëvizje të kësaj Gjykate për t'u shprehur për themelin e çështjes, për sa kohë që pa një vendim të këtij organi Gjykata nuk mund të shqyrtojë kërkesa të tilla (shih paragrafin 55 të vendimit). Ndërkohë, pika 4 e nenit 70 të Kushtetutës përcakton se për çdo shkelje të paragrafit 3 të këtij neni, me mocion të Kryetarit të Kuvendit ose të një të dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatë, e cila konstaton papajtueshmërinë. Pra, konstatimi i papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetit për shkelje të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës është një çështje që i përket juridiksionit të Gjykatës, juridiksion ky që aktivizohet vetëm me kërkesë të Kuvendit. Për sa kohë që ky i fundit nuk ka vendosur për dërgimin e çështjes në Gjykatë, juridiksioni i saj për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka për shkelje të ndalimeve sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, nuk është aktivizuar.

12. Këshilli i Legjislacionit i mori në shqyrtim këto vendime bazuar në nenin 87, pika 1, shkronja "c", të Rregullores së Kuvendit. Këshilli i Legjislacionit, menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare, mori në shqyrtim dhe analizoi vendimet nr 1/2023; nr.2/2023 të Gjykatës Kushtetuese me qëllim zbatimin e tyre. Për shkak të nevojës së qartësisë të çështjeve me synim zbatimin e këtyre vendimeve, çështje që lindnin nga vetë arsyetimi i tyre, detyrimi për të respektuar konsistencën

me praktikën e mëparshme të Gjykatës Kushtetuese si dhe evoluimin e kuadrit kushtetues e ligjor të zbatueshëm për shqyrtimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, Këshilli i Legjislacionit kreu një proces parlamentar shterues. Këshilli, ndër të tjera, gjatë shqyrtimit caktoi ekspert konstitucionalist, i cili u dha përgjigje pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e tij, përfaqësues të shumicës dhe pakicës parlamentare.

13. Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli për Legjislacionin i njoftoi raportin këshillimor Kryetares së Kuvendit, ku u përfshi mendimi i pakicës dhe shumicës parlamentare. Pakica mbajti qëndrimin që çështja t'i dërgohej seancës plenare për të vendosur dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese; ndërsa shumica vlerësoi që çështja përpara se të kalonte në seancë plenare duhej shqyrtuar nga Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

14. Shumica në Këshillin e Legjislacionit vlerësoi se duke pasur në konsideratë kompetencat e listuara nga neni 13 i Rregullores së Kuvendit, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin duhet që të vlerësojë kërkesën për mocion si edhe Rregulloren e Kuvendit në përputhje me gjetjet e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, në vendimet e saj nr.1, datë 23.1.2023 dhe nr.2, datë 23.1.2023. Respektimi i kërkesave të Rregullores së Kuvendit, duke i kërkuar Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin që të bëjë vlerësimin e mësipërm, është kërkesë e nenit 78, pika 2 e Kushtetutës, sipas të cilës: *Mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas rregullores, nuk sjellin asnjë pasojë.*

Për këtë arsye nëse procedohej me dërgimin e kërkesës për mocion drejtpërdrejtë në seancë plenare, pa respektuar kërkesat e Rregullores së Kuvendit, veçanërisht ato të nenit 13 dhe nenit 119/1, bën që mbledhja e Kuvendit që do të duhet të vendosë për dërgimin e çështjes së pajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve nga deputetja Olta Xhaçka, në Gjykatën Kushtetuese, siç e kërkonin përfaqësuesit e pakicës parlamentare në Këshillin e Legjislacionit, të mos sillte asnjë pasojë.

15. Kryetarja e Kuvendit u njoh me raportin e Këshillit të Legjislacionit në datën 23.07.2023, në përfundim të sesionit parlamentar. Pas konsultimit të raportit sipas procedurave të Kuvendit, Kryetarja referuar nenit 78, pika 2 të Kushtetutës, dhe neneve 13, 119/1, 116 të Rregullores vlerësoi të thërrasë mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Për shkak të situatës së krijuar në Kuvend prej bllokimit të punimeve parlamentare nga një pjesë e deputetëve të opozitës, Këshilli e kishte të pamundur të mblidhej në ato kushte anormaliteti të veprimtarisë parlamentare për disa muaj. Pas kthimit në normalitet të punimeve të Kuvendit, Kryetarja njoftoi në Konferencën e Kryetarëve të datës 03.04.2024 se mbledhja e Këshillit të Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit do të thirrej menjëherë dhe me shkresën datë 03.04.2024 u njoftua zhvillimi i mbledhjes në datë 8 Prill 2024.

16. Në mbledhjen e Këshillit të Mandateve pas diskutimeve u vendos që çështja të bëhej pjesë e rendit të ditës së seancës më të parë. Pakica dhe shumica parlamentare teksa nuk u pajtuan për një raport të përbashkët, i paraqitën seancës plenare raporte të veçanta. Deputetët e pakicës parlamentare, në raportin përkatës i kanë kërkuar seancës plenare që të vendosë dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese. Në raportin e saj shumica parlamentare vlerësoi që çështja t'i kalojë seancës plenare për të vendosur në lidhje me dërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese sipas parashikimeve të nenit 70 të Kushtetutës.

17. Shumica parlamentare në raportin përkatës, në mënyrë të përmbledhur nënvizoi se:

Sipas shumicës, në Kushtetutë parashikohen dy rrugë për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit: i) nëpërmjet Kuvendit, që vihet në lëvizje me mocion të Kryetarit ose 1/10 të deputetëve (neni 70, pika 4 e Kushtetutës); ii) nëpërmjet grupimit të 1/5 së deputetëve sipas nenit 134, pika 1, gërma “c” të Kushtetutës.

Në vitin 2016, Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.7/2016, ku bëri dhe një interpretim përfundimtar të nenit 70 të Kushtetutës, vendosi që pavarësisht parashikimit kushtetues, 1/5 e deputetëve nuk legjitimohej direkt për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese dhe Kuvendi në cdo rast duhej t'a dërgonte kërkesën/mocionin për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit në Gjykatën Kushtetuese sapo t'i paraqitej. Pas këtij vendimi, Kuvendi dërgonte çdo kërkesë/mocion në Gjykatë Kushtetuese.

Me dy vendime të mëvonshme (rastet Valentina Leskaj, vendimi i Kolegjit nr.93/2016 dhe Rakip Suli, vendimi nr.72/2016) po të vitit 2016, marrë pas vendimit n.7/2016, Gjykata Kushtetuese vendosi që Kuvendi nuk kishte pse dërgonte çdo mocion në Gjykatën Kushtetuese, po vetëm ato që lidheshin me papajtueshmërinë që sjell humbjen e mandatit të deputetit (rastet që parashikohen në pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës - kur vetë deputeti me veprimet e tij shkel ndalimin kushtetues të parashikuar në këtë dispozitë, pra nëse kryen veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor, ose fiton pasuri të këtyre); Rastet e tjera Kuvendi, sipas Gjykatës Kushtetuese, duhej t'i shqyrtonte vetë.

Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, dispozitat kushtetuese që parashikojnë të drejtën e 1/5 së deputetëve për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për rastet e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, mbetën pa u ndryshuar (neni 131 dhe 134 të Kushtetutës).

Gjithashtu, me ndryshimet në Ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, në vitin 2016, Kuvendi miratoi nje parashikim të ri, (neni 66) ku shprehimisht 1/5 e deputetëve ose Kuvendi janë subjekt që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit. Në vitin 2019, Kuvendi miratoi ndryshime në Rregullore, ku midis të tjerave shtoi nenin 119/1 për të përputhur jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, dispozitë që parashikon se kërkesat për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit vleresohen nga pikëpamja juridiko formale prima facie (në një vështrim të parë) prej Kuvendit, pa i hyrë thelbit, nëse janë sipas kriterëve të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, (pra veç ato kërkesa/mocione që lidhen me përfitim nga deputeti drejtëpërdrejt të pasurisë publike). Kjo sepse, sipas vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për rastet V.Leskaj e R.Suli çështjet që lidhen me kriteret e pikës 2 të nenit 70 nuk hyjnë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese e nuk kanë pse dërgohen në atë gjykatë për shqyrtim.

Të dyja mocionet/kërkesat që u paraqitën për rastin e deputetes Olta Xhacka, Kuvendi i shqyrtoi sipas jurisprudencës kushtetuese dhe kuadrit të ri ligjor pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese n.7/2016, dhe me shumicë votash vendosi mosdërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese duke vlerësuar se nuk plotësoheshin kriteret e nenit 70, pika 3 të Kushtetutës (vlerësimi prima facie),

pasi nuk rezultonte që deputetja të kishte përfitur vetë pasuri publike ose fitime nga pasuria publike.

Grupimi i 1/5 së deputetëve që legjitimohej t'i drejtohej direkt Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhacka paraqiti në këtë Gjykatë kërkesën përkatëse. Gjykata Kushtetuese e shqyrtoi këtë kërkesë të 1/5 së deputetëve në Kolegj, në mbledhjen e Gjyqtarëve dhe në seancë plenare. Rezulton se kjo kërkesë është shqyrtuar në themel. Palët, kërkesit dhe deputetja Olta Xhacka, nëpërmjet përfaqësuesve/avokatëve të tyre, kanë paraqitur pretendimet dhe kërkesat përkatëse, provat ku i mbështesnin ato, i janë përgjigjur pyetjeve të njëra tjetrës dhe të gjykatës, është ezauruar në bazë të parimit të kontradiktoritetit debati gjyqësor, janë paraqitur kërkimet përfundimtare. Pavarësisht ezaurimit procedural të shqyrtimit në themel, gjykata nuk ka dhënë një vendim në lidhje me themelin e çështjes, por ka disponuar me vendim n.2/2023 për pushimin e gjykimit të çështjes, me arsyetimin se Gjykata Kushtetuese nuk e merr dot çështjen në shqyrtim pa ia dërguar Kuvendi.

Këtë arsyetim Gjykata Kushtetuese e lidh dhe me arsyetimin e vendimit tjetër të saj, atë me nr.1/2023, konkretisht vendimi që lidhet me kërkesën e 1/10 të deputetëve, të cilët kundërshtuan në Gjykatën Kushtetuese vendimin e Kuvendit për mosdërgimin e mocionit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhacka në këtë Gjykatë, duke e trajtuar si konflikt kompetence midis kërkesve (1/10 e deputetëve) dhe Kuvendit.

Sipas shumicës, në bazë të kuadrit kushtetues dhe ligjor në fuqi (ndryshimeve ligjore pas vendimit nr.7/2016 të Gjykatës Kushtetuese), në trajtimin e çështjes së mandatit të deputetes Olta Xhacka, ishte pritshmëri legjitime në përputhje me parimin e sigurisë juridike që Gjykata, teksa mori në shqyrtim në themel kërkesën e 1/5 të deputetëve të shprehej për kërkimin nga ana substanciale e të vendoste nëse deputetja Olta Xhacka ishte apo jo para një rasti papajtueshmërie të mandatit të deputetit.

Me vendimet n.1 dhe n.2 të vitit 2023 për rastin Olta Xhacka, Gjykata Kushtetuese ka lënë pa fuqi (por të pashfuqizuara) dispozita kushtetuese dhe ligjore që legjitimojnë 1/5 e deputetëve të Kuvendit t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit.

Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 1/2023, arsyeton se Kuvendi duhet të dërgojë mocionin në Gjykatën Kushtetuese, ndërsa pika 4, neni 70 i Kushtetutës shprehimisht thotë që Kuvendi vendos të dërgoje çështjen në Gjykatën Kushtetuese. Neni 70, pika 1 e Kushtetutës parashikon se mandati i deputetit nuk është detyrues, ç'ka nënkupton të drejtën e deputetit të ndjekë bindjet e tij ose të saj. Kuvendi në ushtrim të kompetencave të tij kushtetuese dhe në cilësinë e organit që krijon norma kushtetuese, ka detyrim të zbatojë jo vetëm një vendim të saj, por gjithë vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Me pak fjalë, mandati jodetyrues (neni 70/1 i Kushtetutës) nuk nënkupton të drejta pa kufij, sepse deputeti ka detyrim të zbatojë Kushtetutën dhe ligjin. Kushtetuta detyron deputetët të zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, por çështja që kërkonte sqarim, sipas shumicës, ishte si duhej të vepronte Kuvendi kur ka disa vendime të Gjykatës Kushtetuese që janë në fuqi (pra kanë secili vendim të njëjtën vlerë detyruese) dhe mbajnë qëndrime të ndryshme për të njëjtat natyra çështjesh. Sipas shumicës, vendimarrja e Kuvendit nuk lidhej vetëm me një mandat deputeti, por me standarde kushtetuese, leximin e duhur të vullnetit të kushtetutëbërësit, balancat në demokraci, dhe respektimin e parimit të sigurisë juridike.

18. Në seancën plenare të datës 11.04.2024, me vendimin nr. 41/2024, datë 11.04.2024 (vendimi nr. 41/2024), Kuvendi, nuk ka miratuar dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të mocionit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka.

19. Në datën 24.04.2024 një grup prej 44 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjekteve kushtetuese jo më pak se 1/10-ta dhe jo më pak se 1/5-ta e deputetëve, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë, me objekt: *“1. Kundërshtimi i vendimit nr. 41/2024, datë 11.04.2024 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosdërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese” dhe deklarimi i këtij vendimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. 2. Zgjidhja e konfliktit të kompetencave ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10 e deputetëve, duke përcaktuar mënyrën kushtetuese konkrete se si zgjidhet ky konflikt dhe se si ushtrohet e drejta kushtetuese e pakicës parlamentare (një të dhjetës së deputetëve) për të mos u penguar mocioni i saj nga Kuvendi në kushtet e mosverifikimit të pengesave formale, në kushtet kur mazhoranca, me votim, ka vendosur moszbatimin e vendimit nr. 1, datë 23.01.2023 të Gjykatës Kushtetuese dhe kjo mund të ripërsëritet në të ardhmen. Interpretimi përfundimtar i neneve 70, pikat 1 dhe 4, 73, pika 1 dhe 132, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.”*

20. Në datën 14.05.2024 Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike. Kuvendi gjatë shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese, në bazë të nenit 44/b të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, kërkoi riçeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe marrjen e një mendimi (*amicus curia*) nga Komisioni për Demokraci nëpërmjet Ligjit - Komisioni i Venecias, duke drejtuar këto pyetje:

- ✓ Bazuar në parimet e demokracisë parlamentare përfaqësuese, a mund të detyrohen deputetët që të votojnë në një mënyrë të caktuar? Nëse ka përjashtime të tilla, cilat janë ato dhe a kanë lidhje me rastin e mocioneve për pajtueshmërinë e mandatit të një deputetit?
- ✓ Cilat janë standardet për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit nga organet legjislativ të shteteve të ndryshme dhe cili është roli i organit respektiv legjislativ në konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit?
- ✓ Mbi bazë të cilave standarde do të duhet të interpretohet raporti mes mandatit përfaqësues, jo detyrues që deputetët gëzojnë dhe rolit tyre si anëtarë të Kuvendit në rastin e shqyrtimit të mocioneve për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit?
- ✓ Cili është roli i organit legjislativ lidhur me konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit në shtete të tjera dhe a ka një kontroll gjyqësor ndaj vendimmarrjes së tyre? Nëse po, në ç’raporte është kompetenca që organi legjislativ ka në këtë procedurë, krahasuar me kompetenën e gjykatës përkatëse? Cili prej këtyre organeve ushtron kontroll thelbësor të mocionit për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit? Cili është subjekti që legjitimohet që ta dërgojë çështjen në gjykatën e caktuar?
- ✓ Cilat janë parimet dhe kriteret që do të duhet të merren në konsideratë nga gjykatat për të përligjur ndryshimin e jurisprudencës së tyre?

Sipas kërkuarit, krijohet një pasiguri juridike, se përse grupi prej jo më pak se një e pesta e

deputetëve nuk mundet që të vendosë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, në kundërshtim me rendin kushtetues në fuqi dhe duhej të kërkohej një mendim këshillimor nga ana e Komisionit të Venecias, dhe në lidhje me zbatueshmërinë e këtyre parashikimeve kushtetuese dhe ligjore që lidhen me të drejtën e një të pestës së deputetëve të Kuvendit për të vendosur në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Kërkesa e Kuvendit, nuk u pranua nga Gjykata.

21. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 55/2024, Gjykata Kushtetuese ka vendosur:

“1. Pranimin pjesërisht të kërkesës. 2. Zgjidhjen e konfliktit/mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt jo më pak se 1/10-ta e deputetëve. 3. Shfuqizimin e vendimit nr. 41/2024, datë 11.04.2024 “Për mosdërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese” të Kuvendit të Shqipërisë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. 4. Detyrimin e Kuvendit të Shqipërisë për dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të mocionit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka.”

22. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 55, datë 10.07.2024 u publikua në Fletoren Zyrtare nr. 139, datë 7 Gusht 2024. Për pasojë, sipas pikës 2, të nenit 132 të Kushtetutës vendimi nr. 55/2024 i Gjykatës Kushtetuese ka hyrë në fuqi më datë 7 Gusht 2024.

23. Me shkresën nr. 3155 Prot., datë 07.08.2024, një grup prej 29 deputetësh i ka kërkuar Kryetares së Kuvendit thirrjen e Kuvendit në sesion të jashtëzakonshëm, me qëllim zbatimin e vendimit nr. 55/2024 të Gjykatës Kushtetuese. Kryetarja e Kuvendit përmes shkresës nr. 3155/1 Prot., datë 08.08.2024 ka argumentuar se përpara mbledhjes së Kuvendit, duhet të mbledhet Këshilli i Legjislacionit. Për këtë arsye, në mbështetje të nenit 7, pika 6; nenit 14, pika 6; nenit 32 dhe nenit 87 të Rregullores së Kuvendit, Kryetarja e Kuvendit përmes urdhrin nr. 54, datë 08.08.2024, ka urdhëruar thirrjen jashtë sesionit të Këshillit të Legjislacionit, në datë 27.08.2024, ora 11:00, me rend dite: “Shqyrtimin e vendimit nr. 55, datë 10.07.2024 të Gjykatës Kushtetuese”.

24. Mbledhja e Këshillit të Legjislacionit u zhvillua në datën 27.08.2024, ku anëtarët e shumicës dhe pakicës çmuan të paraqesin raporte të veçanta, ndërsa të gjithë anëtarët vlerësuan se çështja duhet të kalojë në seancën plenare më të afërt për të vendosur për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese.

III. Vlerësimi

25. Në lidhje me aspektin procedural: Anëtarët e shumicës në Këshillin e Legjislacionit vlerësojnë të drejtë dhe në përputhje me Kushtetutën urdhrin e Kryetares së Kuvendit nr. 54, datë 08.08.2024 që çështjen e zbatimit të vendimit nr. 55, datë 10.07.2024 të Gjykatës Kushtetuese t’a shqyrtojë paraprakisht Këshilli për Legjislacionin.

26. Këshilli i Legjislacionit e merr në shqyrtim çështjen në kuadër të procedurës parlamentare për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese parashikuar në nenin 87 të Rregullores së Kuvendit. Vendimi nr.55, datë 10.07.2024 i Gjykatës Kushtetuese lidhet me një *”mosmarrëveshje të kompetencës kur Kuvendi është palë“*; ndaj në kuptim të pikës 1, gërma c të nenit 87 të Rregullores, Këshilli i Legjislacionit është organi kompetent për shqyrtimin e çështjes.

27. Si në këtë rast ku çështja në shqyrtim lidhet me zbatimin e vendimit nr. 55/2024 të Gjykatës Kushtetuese, edhe në rastin e mëparshëm të zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nr.1/2023, nr.2/2023, Kuvendi ka ushtruar funksionet e veta në kuadër të zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, jo si një procedurë e zakonshme parlamentare, por si një procedurë parlamentare për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Detyrimi për zbatimin e kësaj procedure rrjedh nga neni 75 i Kushtetutës ku shprehimisht thuhet “Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve” dhe në zbatimin të Rregullores së Kuvendit nenit 87. Gjithashtu, kjo procedurë parlamentare ushtrohet dhe në zbatim të detyrimit kushtetues parashikuar në nenin 78 të Kushtetutës që thotë “Mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas rregullores, nuk sjellin asnjë pasojë”.

28. Anëtarët e shumicës në Këshillin e Legjislacionit, çmojnë gjithashtu të sqarojnë se Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin është organi që shqyrton paraprakisht mocionet për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit, por për sa kohë nuk rezulton ndonjë fakt apo rrethanë e re për rastin në shqyrtim, kalimi i çështjes në këtë Këshill do të ishte thjesht formal. Këshilli për Rregulloren, Mandatet i ka shprehur mendimet me raportin datë 10.04.2024 duke iu përmbajtur arsyetimit të vendimit nr.1/2023 të Gjykatës Kushtetuese.

Për këtë arsye, anëtarët e shumicës në Këshillin e Legjislacionit vlerësojnë se çështja duhet të dërgohet për votim në seancën plenare të Kuvendit, pa qenë nevoja në këtë rast për t’u shqyrtuar paraprakisht në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

29. Në lidhje me thelbin e çështjes, zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.55/2024:

Gjykata Kushtetuese ka vendosur:

“1. Pranimin pjesërisht të kërkesës. 2. Zgjidhjen e konfliktit/mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt jo më pak se 1/10-ta e deputetëve. 3. Shfuqizimin e vendimit nr. 41/2024, datë 11.04.2024 “Për mosdërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese” të Kuvendit të Shqipërisë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. 4. Detyrimin e Kuvendit të Shqipërisë për dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të mocionit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka.”.

30. Në arsyetimin e vendimit nr.55/2024, ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese për themelin e çështjes, shprehet:

“.....

46.Gjykata, në rastin konkret, do të verifikojë nëse Kuvendi ka zbatuar vendimin e saj nr. 1/2023 dhe, mbi këtë bazë, do të vlerësojë mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes së parashtruar para saj. ...

54. Gjykata rithekson se vendimi i saj nr. 1/2023 ka shprehur qartë detyrimin e Kuvendit që me vendim të dërgojë kërkesën për papajtueshmërinë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës para kësaj Gjykate, si organi i vetëm që do të

shqyrtojë në themel faktet, për të përcaktuar nëse ato duhet të klasifikohen në parashikimet e pikës 2 ose pikës 3 të nenit 70, të Kushtetutës.

55. Gjykata çmon të ndalet fillimisht në analizën e parimit të mandatit të lirë (jodetyrues) të deputetit dhe të rolit të Kuvendit, si interpretues i normave kushtetuese, të cilat janë paraqitur nga Kuvendi si shkaqe që përlligjin, sipas tij, vendimmarrjen e kundërshtuar në këtë gjykim.

58. Gjykata vlerëson se parimi kushtetues i mandatit të lirë të një deputeti nuk mund të kuptohet si liri absolute e tij, që nuk kufizohet nga Kushtetuta dhe ligjet, për të vepruar në një mënyrë të tillë që Kuvendi të mos jetë në gjendje të zbatojë kërkesat që burojnë nga Kushtetuta dhe të miratojë vendime të papajtueshme me të. Prandaj, Gjykata çmon se parimi i mandatit të lirë (jodetyrues), edhe pse është i zbatueshëm në procedurat parlamentare kur deputetët thirren në votim, nuk nënkupton se liria në votim e deputetit është absolute. Përkundrazi, kjo liri në votim e tij u nënshtrohet kufizimeve që rrjedhin nga parimet e supremacisë së Kushtetutës, të shtetit të së drejtës dhe të kushtetutshmërisë, element i të cilave është edhe detyrueshmëria e zbatimit të vendimeve të Gjykatës. Në këtë kuptim, parimi i mandatit të lirë të deputetit nuk mund të shtrihet në çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e vendimeve të Gjykatës në rastet kur ajo ka përcaktuar për Kuvendin detyrime konkrete që nuk lënë hapësirë vlerësimi për mënyrën e zbatimit nga ana e tij.

59. Për sa i takon rolin të Kuvendit si interpretuesi i parë i normës kushtetuese, Gjykata çmon të ndalet në kufijtë e interpretimit të Kuvendit. Edhe pse në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se Kuvendi shfaqet edhe si interpretuesi i parë i normës kushtetuese (shih vendimet nr. 16, datë 27.06.2022; nr. 9, datë 01.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese), ky organ mund të ndërhyjë deri atje dhe vetëm për ato çështje që Gjykata nuk është shprehur, si organi i vetëm që bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës sipas nenit 132 të saj. Nëse kjo ka ndodhur, Kuvendi nuk mund të ushtrojë më rolin e interpretuesit të parë të normës kushtetuese.

60. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se një interpretim i ndryshëm i parimit të mandatit të lirë (jodetyrues) të deputetit dhe të rolit të Kuvendit, si interpretues i normave kushtetuese, në rastin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës, passjell mundësinë e përplasjes mes dispozitave kushtetuese, krijimin e kontradiktave të brendshme dhe cënimin e harmonisë në sistemin e normave kushtetuese, çka është e palejueshme për rendin kushtetues, pasi vë në dyshim epërsinë e Kushtetutës, rezultat që nuk pajtohet me parimin e shtetit të së drejtës dhe atë të kushtetutshmërisë, të cilat i detyrojnë të gjitha organet e pushtetit publik, përfshirë edhe Kuvendin, që t'i ushtrojnë funksionet e tyre brenda kufijve kushtetues.

61. Bazuar në sa më lart, në rastin konkret, në lidhje me pretendimin për mandatin jodetyrues të deputetit, Gjykata vlerëson se procedura e vendimmarrjes së Kuvendit, që është kundërshtuar në këtë gjykim dhe votimi i deputetëve në atë rast, nuk mund të përlligjet me parimin e mandatit jodetyrues të deputetit, për shkak se zbatimi i vendimit të Gjykatës nuk është një çështje politike, rast në të cilin Kuvendi ka hapësirë vlerësimi dhe deputeti gëzon lirinë e zgjedhjes së qëndrimit përmes votimit sipas mandatit të lirë. Nisur nga kjo, Gjykata vlerëson se Kuvendi nuk ka vepruar në përputhje me Kushtetutën për sa kohë çështjen e ekzekutimit të vendimit të saj ia ka nënshtruar vlerësimin të Këshillit për Legjislacionin dhe Këshillit për Mandatet, struktura në të cilat shumica

parlamentare ka vënë në dyshim fuqinë detyruese të vendimit të Gjykatës, ka thirrur ekspert të jashtëm dhe, më pas, ka vlerësuar se çështja duhet t'i përcillet për votim seancës plenare, votim në të cilin gjente zbatim parimi i mandatit jodetyrues. Gjykata thekson se zbatimi i vendimit të saj në rastin konkret nuk është një procedurë e zakonshme parlamentare, por një procedurë për ekzekutimin e një detyrimi konkret të lindur prej tij, sikurse është ai për dërgimin asaj të çështjes së papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka të ngritur mbi mocionin e 1/10-ës së deputetëve, ndaj qëndrimi i Kuvendit në këtë drejtim është i pabazuar.

62. Po ashtu, në lidhje me pretendimin për rolin e Kuvendit si interpretues i normave kushtetuese, Gjykata vlerëson se Kuvendi në rastin konkret shfaqet në pozitat e çdo organi/institucioni që është i detyruar të veprojë në përputhje me përcaktimet e vendimit të saj. Ai nuk ka hapësirë për interpretimin e normave kushtetuese, pasi nuk është në pozitat e interpretuesit të parë dhe origjinal të tyre, për sa kohë që për çështjen konkrete është shprehur Gjykata, e cila në vendimmarrjen e saj ka konstatuar se mocioni i jo më pak se 1/10-ës së deputetëve plotëson kriteret juridiko-formale për vënien e saj në lëvizje nga Kuvendi, ndaj ky i fundit nuk ka pasur hapësirë për të vlerësuar sërish ato, çka për pasojë bën të pabazuar edhe këtë qëndrim të Kuvendit.

63. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se Kuvendi nuk ka respektuar vendimmarrjen e Gjykatës, në kundërshtim me detyrimin kushtetues që buron nga neni 132 i Kushtetutës. Duke mos respektuar këtë detyrim, Kuvendi ka shkaktuar një mosmarrëveshje të re kushtetuese, pasi, përmes vendimmarrjes së tij, ka cënuar të drejtën kushtetuese të jo më pak se 1/10-ës së deputetëve për t'iu drejtuar Gjykatës për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka, duke penguar mocionin e tyre pavarësisht mosekzistencës së pengesave juridiko-formale.

64. Bazuar në këto konsiderata, Gjykata çmon se pretendimet e subjektit jo më pak se 1/10-ta e deputetëve janë të bazuara, ndaj kërkesa e tij duhet të pranohet, duke zgjidhur mosmarrëveshjen e kompetencës ndërmjet këtij subjekti dhe Kuvendit, shfuqizuar vendimin nr. 41/2024 të Kuvendit si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe detyruar Kuvendin për dërgimin në Gjykatë të mocionit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka.

65. Ndërkohë, Gjykata, në kontekst të rrethanave të rastit dhe në raport me përcaktimet e nenit 66/a, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 në lidhje me afatin maksimal të paraqitjes asaj të kërkesës nga Kuvendi, konsideron të theksojë se shqyrtimi i çështjes nga Kuvendi duhet të bëhet me përparësi, për t'i hapur rrugë ushtrimit nga Gjykata të kompetencave të saj.

.....

67. Në përfundim, nisur nga fakti që objekti i këtij shqyrtimi lidhej me kërtime të veçanta të dy subjekteve të ndryshme, ku vetëm njëri kërkim u gjet i bazuar, Gjykata çmon se për sa i përket kërkesës në tërësi, ajo duhet të pranohet pjesërisht....

.....”

31. Në vendimin nr.55/2024, në pikën 66, Gjykata Kushtetuese shprehet se:

66. Në lidhje me kërkesën e kërkuarit jo më pak se 1/5-ta e deputetëve, për interpretimin përfundimtar të neneve 70, pikat 1 dhe 4, 73, pika 1 dhe 132, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se në rastin konkret interpretimi i këtyre dispozitave kushtetuese ka marrë përgjigje në arsyetimin e mësipërm të këtij vendimi, i cili ka mbajtur në konsideratë edhe jurisprudencën e saj të mëparshme. Për rrjedhojë, ajo vlerëson të mos ndalet në analizimin e kriterëve paraprake dhe themelin e çështjes.

32. Neni 132 i Kushtetutës shprehimisht thotë: **“Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim”**.

33. Për sa më sipër dhe në respektim të nenit 132 të Kushtetutës, anëtarët e shumicës në Këshillin e Legjislacionit, çmojnë t’i rekomandojnë Kryetares së Kuvendit që të vërë në dispozicion dhe t’i bëjë me dije seancës plenare të Kuvendit vendimin e plotë të Gjykatës Kushtetuese nr.55, datë 10.07.2024.

34. Është seanca plenare si organi vendimarrës i Kuvendit, që duhet të vendosë dërgimin e çështjes së papajtueshmërisë së mandatit të deputetes Olta Xhacca në Gjykatën Kushtetuese, referuar nenit 70, pika 4 të Kushtetutës dhe urdhërimeve të Gjykatës Kushtetuese në dispozitivin dhe arsyetimin e vendimit të saj nr.55, datë 10.07.2024.

35. Për këtë arsye, në seancën më të afërt plenare të Kuvendit, kjo çështje duhet të përfshihet në rendin e ditës për votim si projektvendim **“Për dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të mocionit të 1/10 së deputetëve për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhacca”**.

Anëtarët e Shumicës Parlamentare

Ermonela Felaj

Etilda Gjonaj

Klotilda Bushka

Blendi Klosi

Toni Gogu


Seancës Plenare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Këshilli për Legjislacionin



Dokument parlamentar
Tiranë, më 27 Gusht 2024

Drejtuar:

Kuvendit të Shqipërisë
Znj. Elisa Spiropali
Kryetare e Kuvendit

R A P O R T

I

KËSHILLIT PËR LEGJISLACIONIN

Lidhur me vendimin nr. 55, datë 10.07.2024 të Gjykatës Kushtetuese¹

Baza Ligjore:

- Nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës
- Neni 81 i ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
- Nenet 14 dhe 87 të Rregullores së Kuvendit

¹ Hyr në fuqi më 07.08.2024, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 139, datë 07.08.2024

I. HYRJE

1. Kuvendi i Shqipërisë përmes vendimit nr. 41/2024, datë 11.04.2024 ka vendosur për mosdërgimin e mocionit të 1/10 së deputetëve të Kuvendit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes znj. Olta Xhacca për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese. Më datë 24.04.2024, një grup prej 44 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjekteve kushtetuese jo më pak se 1/10 dhe jo më pak se 1/5 e deputetëve, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave midis tyre dhe Kuvendit të Shqipërisë. Më datë 21.06.2024 dhe 25.06.2024 Gjykata Kushtetuese mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen në prani të kërkuarit, Kuvendit të Shqipërisë dhe përfaqësuesit ligjor të deputetes znj. Olta Xhacca.

2. Më datë 10.07.2024 Gjykata Kushtetuese shpalli vendimin e saj, përmes një konference publike të Kryetares së Gjykatës znj. Holta Zacak (*përmbajtja e deklaratës publike gjendet në Aneksin 1, bashkëlidhur këtij Raporti*), si dhe publikoi në faqen zyrtare në internet dispozitivin e vendimmarrjes. Më datë 30.07.2024, vendimi i plotë i arsyetuar i Gjykatës Kushtetuese u shpall në faqen zyrtare në internet të Gjykatës Kushtetuese dhe iu njoftua zyrtarisht palëve në proces, përfshirë Kuvendit të Shqipërisë. Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese u publikua në Fletoren Zyrtare nr. 139, datë 7 Gusht 2024. Për pasojë, sipas pikës 2, të nenit 132 të Kushtetutës vendimi nr. 55/2024 i Gjykatës Kushtetuese ka hyrë në fuqi më datë 7 Gusht 2024.

3. Vendimi nr. 55/2024 ka zgjidhur një konflikt kompetencash midis subjekteve kushtetuese 1/10 e deputetëve (kërkuar të mocionit), si dhe Kuvendit të Shqipërisë. Në këtë rast, konflikti i kompetencave mund të përmblihet sipas rrethanave të faktit si më poshtë:

3.1. Në datën 20.06.2022 një grup prej 14 deputetësh të pakicës parlamentare, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se 1/10-ta e deputetëve, i është drejtuar Kuvendit me mocion, sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhacca (mocioni i parë), duke pretenduar ushtrimin nga kjo e fundit të funksionit të deputetes në kundërshtim me nenin 70 pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës, me argumentet se shoqëria tregtare në pronësi të bashkëshortit të saj dhe, për rrjedhojë, edhe të deputetes në fjalë, ka përfituar të drejta pasurore nga pasuri të shtetit.

3.2. Në datën 01.07.2022 një grup tjetër prej 15 deputetësh, po të pakicës parlamentare, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se 1/10-ta e deputetëve, ka depozituar në Kuvend një kërkesë për mocion drejtuar Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin (Këshilli për Mandatet) me të njëjtin objekt dhe argumente mbështetëse (mocioni i dytë).

3.3. Mocionet janë bashkuar, duke u shqyrtuar në një procedurë të vetme nga Këshilli për Mandatet. Në përfundim të shqyrtimit, pakica dhe shumica parlamentare në këtë këshill kanë prezantuar raportet përfundimtare, duke dalë me qëndrime të kundërta rreth plotësimit të kriterëve kushtetuese për dërgimin nga Kuvendi të çështjes në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata). Raportet i kanë kaluar për shqyrtim seancës plenare të Kuvendit, i cili, me vendimin nr. 83, datë 17.11.2022 (vendimi nr. 83/2022), ka vendosur mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare, kurse me vendimin nr. 84, datë 17.11.2022 (vendimi nr. 84/2022) ka vendosur miratimin e raportit të shumicës parlamentare, sipas të cilit nuk plotësohen kriteret kushtetuese të parashikuara në nenin 70, pika 3, të Kushtetutës për vënien në lëvizje

të Gjykatës, sipas pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës. Në këtë mënyrë Kuvendi nuk e ka dërguar çështjen në Gjykatë.

3.4. Me kërkesën e datës 18.11.2022, një grup prej 14 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se 1/10-ta e deputetëve, i është drejtuar Gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar mes këtij subjekti dhe Kuvendit, si rrjedhojë e vendimeve të këtij të fundit nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022, si dhe deklarin e tyre të papajtueshme me Kushtetutën (çështja e parë).

3.5. Po në të njëjtën datë, një grup tjetër prej 28 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se 1/5-ta e deputetëve, i janë drejtuar Gjykatës, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit, si të papajtueshme me Kushtetutën dhe konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka (çështja e dytë).

3.6. Për çështjen e parë, me vendimin nr. 1, datë 23.01.2023 (vendimi nr. 1/2023), Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës, zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit dhe subjektit kushtetues në konflikt jo më pak se 1/10-ta e deputetëve dhe shfuqizimin e vendimeve të Kuvendit nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022, si të papajtueshme me Kushtetutën. Sipas Gjykatës, çështja e vlerësimit të papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka i takon vlerësimit të Gjykatës, pasi faktet kërkojnë shqyrtimin në themel, në mënyrë që të mund të përcaktohet nëse duhet të klasifikohen në parashikimet e nenit 70, pika 2 ose nenit 70, pika 3, të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata ka vlerësuar se Kuvendi duhet të kishte pranuar mocionin e kërkuarit dhe t'ia dërgonte asaj çështjen për shqyrtim, në mënyrë që aspektet e pretenduara si papajtueshmëri të mandatit të deputetes t'i nënshtroheshin vlerësimit kushtetues. Vendimi ka hyrë në fuqi në datën 28.02.2023, me botimin e tij në Fletoren Zyrtare nr. 32 të vitit 2023.

3.7. Për çështjen e dytë, me vendimin nr. 2, datë 23.01.2023 (vendimi nr. 2/2023), Gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit. Duke konstatuar se çështja kishte në objektin e saj dy kërkime, në lidhje me kërkimin e parë Gjykata ka vlerësuar se ai ka mbetur pa objekt, në kushtet kur vendimet objekt kërkese ishin shfuqizuar me vendimin e saj nr. 1/2023. Ndërsa për kërkimin e dytë, Gjykata ka vlerësuar se nuk kishte juridiksion për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes sipas pikës 2 të nenit 70 të Kushtetutës, kurse pretendimet sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës kishin marrë përgjigje me vendimin nr. 1/2023, duke vlerësuar se ato përfshiheshin në juridiksionin e saj, por se ky juridiksion nuk ishte aktivizuar ende për sa kohë Kuvendi nuk ia kishte dërguar çështjen asaj. Vendimi ka hyrë në fuqi po në datën 28.02.2023, me botimin e tij në të njëjtën Fletore Zyrtare.

3.8. Në datën 10.03.2023, bazuar në nenin 87 të Rregullores së Kuvendit, Kryetarja e Kuvendit ia ka përcjellë Këshillit për Legjislacionin vendimet nr. 1/2023 dhe nr. 2/2023 të Gjykatës. Në mbledhjet e këtij këshilli është diskutuar rreth qëndrimit të mbajtur nga Gjykata në këto vendime dhe, në kushtet kur midis përfaqësuesve të pakicës dhe shumicës parlamentare në këshill ka pasur qëndrime të ndryshme për detyrimet e përcaktuara nga Gjykata në vendimet e saj, me shumicën e anëtarëve të tij është vendosur caktimi i një eksperti të së drejtës kushtetuese për t'iu përgjigjur pyetjeve të anëtarëve të këshillit në lidhje me këto vendime. Opinioni i ekspertit u është bërë i njohur anëtarëve në datën 27.06.2023, ndërsa në datën 07.07.2023 këshilli ka përgatitur raportin e tij për zbatimin e vendimeve të Gjykatës për çështjen e mandatit të deputetes Olta Xhaçka, i cili i është dërguar në vijim Kryetares së Kuvendit. Raporti nuk përmbante rekomandime, por vetëm analizë të vendimeve të Gjykatës që bazohet në interpretime të caktuara të normave kushtetuese e ligjore dhe qëndrimeve interpretuese të Gjykatës në lidhje me to. Në raport pakica parlamentare ka mbajtur qëndrimin se çështja duhej t'i kalonte seancës plenare për të

vendosur dërgimin e saj në Gjykatë, ndërsa shumica parlamentare ka mbajtur qëndrimin se përpara se t'i kalonte seancës, çështja duhej të shqyrtohej nga Këshilli për Mandatet, si struktura kompetente e parashikuar nga neni 119/1 i Rregullores së Kuvendit.

3.9. Këshilli për Mandatet në mbledhjen e datës 08.04.2024 ka diskutuar mocionin për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka. Në datat 09.04.2024 dhe 10.04.2024, respektivisht, deputetët e pakicës dhe të shumicës parlamentare kanë paraqitur raportet e tyre në lidhje me mocionin dhe zbatimin e vendimit nr. 1/2023 të Gjykatës, ndërsa është kërkuar që çështja t'i kalojë për shqyrtim seancës plenare. Kësaj të fundit, deputetët e pakicës i kanë kërkuar që të vendosë dërgimin e çështjes në Gjykatë, kurse deputetët e shumicës nuk kanë bërë rekomandime.

3.10. Me vendim të Kryetares së Kuvendit, projektvendimi "Mbi raportet e shumicës dhe pakicës së Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka" është bërë pjesë e rendit të ditës së punimeve të Kuvendit të datës 11.04.2024. Në seancën plenare të kësaj date, me vendimin nr. 41/2024, datë 11.04.2024 (vendimi nr. 41/2024), Kuvendi, me shumicën e votave, ka vendosur mosdërgimin në Gjykatë të mocionit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka.

3.11. Në datën 24.04.2024 një grup prej 44 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjekteve kushtetuese jo më pak se 1/10-ta dhe jo më pak se 1/5-ta e deputetëve, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë, me objekt: *"1. Kundërshtimi i vendimit nr. 41/2024, datë 11.04.2024 të Kuvendit të Shqipërisë "Për mosdërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese" dhe deklarimi i këtij vendimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. 2. Zgjidhja e konfliktit të kompetencave ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10 e deputetëve, duke përcaktuar mënyrën kushtetuese konkrete se si zgjidhet ky konflikt dhe se si ushtrohet e drejta kushtetuese e pakicës parlamentare (një të dhjetës së deputetëve) për të mos u penguar mocioni i saj nga Kuvendi në kushtet e mosverifikimit të pengesave formale, në kushtet kur mazhoranca, me votim, ka vendosur moszbatimin e vendimit nr. 1, datë 23.01.2023 të Gjykatës Kushtetuese dhe kjo mund të ripërsëritet në të ardhmen. Interpretimi përfundimtar i neneve 70, pikat 1 dhe 4, 73, pika 1 dhe 132, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë."*

3.12. Në datën 14.05.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike. Në vijim, në kontekst të rrethanave të rastit dhe referuar edhe kërkesës së kërkuarit, Gjykata konsideroi shqyrtimin e çështjes me përparësi, pas përgatitjes së saj për gjykim, duke garantuar të drejtat procedurale të palëve. Me vendimin nr. 55/2024, Gjykata Kushtetuese ka vendosur:

"1. Pranimin pjesërisht të kërkesës. 2. Zgjidhjen e konfliktit/mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt jo më pak se 1/10-ta e deputetëve. 3. Shfuqizimin e vendimit nr. 41/2024, datë 11.04.2024 "Për mosdërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese" të Kuvendit të Shqipërisë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. 4. Detyrimin e Kuvendit të Shqipërisë për dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të mocionit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka."

4. Me shkresën nr. 3155 Prot., datë 07.08.2024, një grup prej 29 deputetësh i ka kërkuar Kryetares së Kuvendit thirrjen e Kuvendit në sesion të jahstëzakonshëm, me qëllim zbatimin e vendimit nr. 55/2024 të Gjykatës Kushtetuese. Kryetarja e Kuvendit përmes shkresës nr. 3155/1 Prot., datë 08.08.2024 ka argumentuar se përpara mbledhjes së Kuvendit, duhet të mbledhet Këshilli i Legjislacionit. Për këtë arsye, në mbështetje të nenit 7, pika 6; nenit 14, pika 6; nenit 32 dhe nenit 87 të Rregullores së Kuvendit,

Kryetarja e Kuvendit përmes urdhërit nr. 54, datë 08.08.2024, ka urdhëruar thirrjen jashtë sesionit të Këshillit të Legjislacionit, në datë 27.08.2024, ora 11:00, me rend dite: “Shqyrtimin e vendimit nr. 55, datë 10.07.2024 të Gjykatës Kushtetuese”.

5. Më datë 27 Gusht 2024 Këshilli për Legjislacion u mbledh sipas urdhrit të Kryetares së Kuvendit nr. 54, datë 08.08.2024, për thirrjen e mbledhjes së Këshillit të Legjislacionit dhe në zbatim të nenit 14, pika 3, të Rregullores, Këshilli u kryesua nga znj. Dhurata Tyli (Çupi). Mbledhja e Këshillit të Legjislacionit u parapri nga njoftimi i saj përmes postës elektronike nga administrata e Kuvendit, sëbashku me dokumentet parlamentare të nevojshme për zhvillimin e mbledhjes, përfshirë një kopje të vendimit nr. 55/2024 të Gjykatës Kushtetuese; një Memo përmbledhëse të përmbajtjes së vendimit të përgatitur nga Kryetarja e Këshillit të Legjislacionit; si dhe nga draft raporti i Këshillit i përgatitur nga Kryetarja e Këshillit, që mundëson shqyrtimin e vendimit nr. 55/2024 të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Legjislacionit, në zbatim të nenit 87 të Rregullores së Kuvendit, mori në shqyrtim dhe analizoi efektet e vendimit nr. 55/2024, të Gjykatës Kushtetuese dhe dokumentet parlamentare të sipërcituara, nga ku konkludoi se vendimi nr. 55/2024 i Gjykatës Kushtetuese ka zgjidhur një konflikt kompetencash dhe nuk përfshihet në rastet kur ka nevojë për plotësim të legjislacionit apo ndërmarrjen e ndonjë iniciative ligjvënëse. Në këtë rast, Këshilli ka vetëm detyrimin për të paraqitur një raport këshillimor Kryetarit të Kuvendit, mbi detyrimet që i lindin Kuvendit të Shqipërisë, si subjekt në këtë konflikt kompetencash, sipas vendimit nr. 55/2024.

II. BAZA LIGJORE

6. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 124 i Kushtetutës

- 1. Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.*
- 2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.*
- 3. Gjykata Kushtetuese ka buxhet të veçantë, të cilin e administron në mënyrë të pavarur.*

Neni 132 i Kushtetutës

- 1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim.*
- 2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë që vendimi i saj, me të cilin ka shqyrtuar aktin, të fillojë efektet në një datë tjetër.*
- 3. Mendimi i pakicës publikohet bashkë me vendimin përfundimtar.*

7. Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese

Vendimi nr. 14, datë 03.06.2009, i Gjykatës Kushtetuese, e cila është shprehur se: “Nenet 124, 132 dhe 145/2 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike dhe gjykatat. Zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues; ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme

dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit (Shih vendimin nr. 5, datë 07.02.2001 të Gjykatës Kushtetuese). Asnjë organ tjetër, me përjashtim të vetë Gjykatës (dhe kjo lidhet me ndryshimin e praktikës, apo rishikimin e Kushtetutës) nuk mund të mos pranojë t'i zbatojë ato. Lënia në vlerësimin e organeve të tjera të vendimeve kushtetuese krijon precedentin e rrezikshëm për t'i mohuar këtij organi funksionin e garantit të Kushtetutës. Roli i Gjykatës qëndron pikërisht në fuqinë detyruese të vendimeve të saj. Formulimi që i ka dhënë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë fuqisë detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese përcakton autoritetin e këtij organi dhe është e vetmja mënyrë e pranueshme për zgjidhjen e drejtë dhe përfundimtare të çështjeve me natyrë kushtetuese.

Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Arsyetimi që përdor Gjykata në vendimet e saj buron nga autoriteti i saj për të thënë fjalën e fundit në çështjet, për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese Gjykata thekson se efekti detyrues shtrihet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj që përbëjnë edhe ratio decidendi, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (Shih vendimet BVerfGE 1, p. 14 dhe BVerfGE 20, p. 56 të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane). Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës është i tillë që iu imponon të gjithë organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj.

8. Ligji nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”

Neni 81

Ekzekutimi i vendimeve

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim.
2. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Këshilli i Ministrave me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore.
3. Gjykata Kushtetuese, në varësi të llojit të vendimit dhe kur është e nevojshme, mund të caktojë në pjesën urdhëruese organin e ngarkuar me zbatimin e vendimit, si dhe mënyrën e ekzekutimit, duke caktuar afate konkrete, mënyrën dhe procedurën përkatëse të ekzekutimit.
4. Moszbatimi ose pengimi i ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal.

9. Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë

Neni 14 i Rregullores

1. Këshilli është organ këshillimor, që vlerëson ose jep mendim për çështje kushtetuese ose ligjore që ngrihen në lidhje me tekstin e projektligjit dhe për çështje të harmonizimit të projektligjit me aktet e tjera ligjore në fuqi ose me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe aktet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.
2. Këshilli për Legjislacionin përbëhet nga 10 deputetë, të emëruar nga Kryetari i Kuvendi, pasi ka marrë më parë mendimin e kryetarëve të grupeve parlamentare. Këshilli siguron përfaqësim të barabartë mes shumicës dhe opozitës parlamentare. Anëtarët e Këshillit janë me profesion jurist ose të kenë përvojë legjislative.

3. Këshilli për Legjislacionin kryesohet me rotacion çdo 5 muaj nga secili anëtar, duke filluar sipas renditjes alfabetike të mbiemrit, duke ruajtur parimin e kryesimit një herë nga shumica dhe një herë nga pakica parlamentare.

6. Kryetari i Kuvendit, bazuar në kërkesën e paraqitur, përcakton rendin e ditës. Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se 5 anëtarë. Diskutimi i çështjeve në Këshill bëhet, për aq sa është e mundur, në mënyrën e parashikuar për komisionet e përhershme.

Neni 87 i Rregullores

1. Kryetari i Kuvendit i përcjell Këshillit për Legjislacionin vendimet e Gjykatës Kushtetuese për:

a) vlerësimin e kushtetutshmërisë së legjislacionit që ka nismëtar deputetin/deputetët;

b) interpretimin përfundimtar të Kushtetutës;

c) zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës kur Kuvendi është palë;

ç) shkarkimin e funksionarëve kushtetues, të cilët zgjidhen nga Kuvendi;

d) rastet kur kërkesa në Gjykatë Kushtetuese është paraqitur nga jo më pak se 1/5 e deputetëve.

2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, që kanë efekt në legjislacion, merren në shqyrtim nga Këshilli për Legjislacionin brenda 30 ditëve pas botimit të tyre në Fletoren Zyrtare.

3. Këshilli analizon dhe diskuton, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Rregullore, efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, për çështjet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Këshilli harton një raport dhe ia paraqet atë Kryetarit të Kuvendit.

4. Raporti i Këshillit, kur çmohet e nevojshme, mund t'i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, Këshillit të Ministrave dhe Presidentit të Republikës.

5. Kur nevojitet marrja e nismës ligjvënëse për plotësime ose ndryshime në legjislacion, Këshilli i paraqet rekomandimet e nevojshme komisionit përgjegjës dhe nismëtarit, ose ndërmer vetë nismën ligjvënëse.

III. FAKTE DHE RRETHANA

10. Kërkuesi jo më pak se 1/10-ta e deputetëve ka pretenduar se vendimi nr. 41/2024 i Kuvendit ka krijuar mosmarrëveshje kompetence mes tij dhe Kuvendit në lidhje me të drejtën për të kërkuar shqyrtimin e papajtueshmërisë me mandatin të deputetes Olta Xhaçka nga Gjykata, duke parashtruar se ai cenon:

10.1. Nenin 70, pika 1, të Kushtetutës, pasi, duke u fshehur pas parimit të mandatit të lirë (jodetyrues) të parashikuar në nenin 73, pika 1, të Kushtetutës, Kuvendi i ka shtrirë efektet e parimit të mandatit jodetyrues të deputetit për të bërë të paaplikueshëm detyrimin për të zbatuar vendimet e Gjykatës, duke cenuar në këtë mënyrë nenin 132 të Kushtetutës.

10.2. Nenin 70, pika 4, të Kushtetutës, pasi ka kufizuar të drejtën e jo më pak se 1/10-ës së deputetëve për të vënë në lëvizje procesin kushtetues të kontrollit të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit. Institucionalizimi i pushtetit të pakicës parlamentare, i materializuar në të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën, është bërë nga kushtetutëbërësi me qëllim shmangien e qëndrimeve politike nga ana e shumicës parlamentare. Nëse do të pranohej një interpretim i ndryshëm, pakica parlamentare do të diskriminohej në raport me shumicën parlamentare, për sa kohë që ushtrimi i kësaj të drejte kushtetuese do të ishte në diskrecionin e kësaj të fundit.

10.3. Standardin e zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës, të garantuar nga neni 132 i Kushtetutës, nga i cili nuk përjashtohet as Kuvendi. Vendimi i kundërshtuar vendos një precedent të rrezikshëm, pasi krijon puç kushtetues institucional të tillë që vë në pikëpyetje ekzistencën e shtetit demokratik. Neni 4 i Kushtetutës e lë në diskrecionin e organeve shtetërore interpretimin e Kushtetutës dhe mënyrën e zbatimit drejtpërdrejt të saj, por nuk u njeh atyre të drejtën e interpretimit përfundimtar, i cili bëhet nga Gjykata. Edhe pse me vendimin nr. 1/2023 Gjykata ka përcaktuar detyrimin e Kuvendit për t'i dërguar asaj çështjen e vlerësimit të pretendimeve të pakicës parlamentare në lidhje me pajtueshmërinë me mandatin të deputetes Olta Xhaçka për shkaqe që kanë të bëjnë me nenin 70, pika 3, të Kushtetutës, me vendimin nr. 41/2024, duke interpretuar vetë dispozitat kushtetuese, Kuvendi ka vendosur, sërish, mosdërgimin e çështjes në Gjykatë, me qëllim pengimin e zbatimit të vendimit nr. 1/2023 të saj. Duke keqinterpretuar dispozitat kushtetuese dhe rolin e tij, Kuvendi ka vënë në pikëpyetje autoritetin e Gjykatës, duke i mohuar asaj ushtrimin e kompetencave që i njeh Kushtetuta.

10.4. Parimin e zgjidhjes së konfliktit mes pushteteve përmes drejtësisë kushtetuese, pasi në mënyrë të përsëritur mazhoranca i ka mohuar pakicës parlamentare të drejtën kushtetuese që t'i drejtohet Gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, me qëllim sigurimin e ushtrimit të të drejtave të saj. Shqyrtimi nga Gjykata i së njëjtës çështje ndërmjet të njëjtave palë nuk përbën res judicata, pasi në rastin konkret bëhet fjalë për pretendime të reja për antikushtetutshmërinë e pretenduar.

10.5. Parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, për shkak të mosmarrëveshjes së kompetencave të krijuar midis subjekteve kushtetuese brenda të njëjtit pushtet, jo më pak se 1/10-ës së deputetëve, nga njëra anë, dhe Kuvendit, nga ana tjetër. Edhe pse në përmbajtjen e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës nuk është përdorur termi “është i detyruar”, kjo nuk nënkupton se vlerësimi në këtë rast është në kompetencë të Kuvendit. Nëse do të pranohej një pushtet i tillë i pakufizuar i Kuvendit, atëherë parashikimi kushtetues do të zhvishej nga qëllimi i tij, çka do të përbente abuzim me pushtetin e shumicës.

11. Në vendimin e plotë nr. 55/2024, një kopje të të cilit e gjeni në Aneksin 2 bashkëlidhur këtij Raporti, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar dhe arsyetuar në mënyrë të përmbledhur sa më poshtë:

11.1. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 1/2023 ka shprehur qartë detyrimin e Kuvendit që me vendim të dërgojë kërkesën për pajtueshmërinë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës para kësaj Gjykate, si organi i vetëm që do të shqyrtojë në themel faktet, për të përcaktuar nëse ato duhet të klasifikohen në parashikimet e pikës 2 ose pikës 3 të nenit 70, të Kushtetutës.

11.2. Kuvendi nuk ka respektuar vendimmarrjen e mësipërme të Gjykatës Kushtetuese, në kundërshtim me detyrimin kushtetues që buron nga neni 132 i Kushtetutës. Ky refuzim i Kuvendit për zbatimin e vendimit të Gjykatës ka çuar në krijimin e një krize kushtetuese që jo vetëm cenon themelet e shtetit demokratik dhe humb besimin e publikut të shteti dhe organet e tij, por vë në diskutim edhe vetë rolin dhe funksionin e Gjykatës.

11.3. Çështja e vlerësimit të pajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes, e cila nëpërmjet bashkëshortit mund të ketë ushtruar veprimtari fitimprurëse që burojnë nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe të ketë fituar pasuri të këtyre, referuar fakteve, nuk i takon vlerësimit të Kuvendit, por vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese, pasi ato (faktet) kërkojnë shqyrtimin në themel, në mënyrë që të mund të përcaktohet nëse duhet të klasifikohen në parashikimet e nenit 70, pika 2 ose nenit 70, pika 3, të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Kuvendi duhet të kishte pranuar mocionin e kërkuarit dhe të

dërgonte çështjen për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, në mënyrë që aspektet e pretenduara si papajtueshmëri të mandatit të deputetes Olta Xhaçka t'i nënshtroheshin vlerësimit kushtetues, pasi gjatë gjykimit kushtetues nuk u verifikua ndonjë pengesë juridiko-formale që mocioni të pengohej nga Kuvendi.

11.4. Procedura e vendimmarrjes së Kuvendit, që është kundërshtuar në këtë gjykim dhe votimi i deputetëve në atë rast, nuk mund të përliqet me parimin e mandatit jodetyrues të deputetit, për shkak se zbatimi i vendimit të Gjykatës nuk është një çështje politike, rast në të cilin Kuvendi ka hapësirë vlerësimi dhe deputeti gëzon lirinë e zgjedhjes së qëndrimit përmes votimit sipas mandatit të lirë. Parimi kushtetues i mandatit të lirë të një deputeti nuk mund të kuptohet si liri absolute e tij, që nuk kufizohet nga Kushtetuta dhe ligjet, për të vepruar në një mënyrë të tillë që Kuvendi të mos jetë në gjendje të zbatojë kërkesat që burojnë nga Kushtetuta dhe të miratojë vendime të papajtueshme me të. Kjo liri në votim e deputetit u nënshtrohet kufizimeve që rrjedhin nga parimet e supremacisë së Kushtetutës, të shtetit të së drejtës dhe të kushtetutshmërisë, element i të cilave është edhe detyrueshmëria e zbatimit të vendimeve të Gjykatës. Në këtë kuptim, parimi i mandatit të lirë të deputetit nuk mund të shtrihet në çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në rastet kur ajo ka përcaktuar për Kuvendin detyrime konkrete që nuk lënë hapësirë vlerësimi për mënyrën e zbatimit nga ana e tij.

11.5. Kuvendi, si interpretuesi i parë i normës kushtetuese, mund të ndërhyjë deri atje dhe vetëm për ato çështje që Gjykata Kushtetuese nuk është shprehur, si organi i vetëm që bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës sipas nenit 132 të saj. Nëse kjo ka ndodhur, Kuvendi nuk mund të ushtrojë më rolin e interpretuesit të parë të normës kushtetuese. Kuvendi në rastin konkret shfaqet në pozitat e çdo organi/institucioni që është i detyruar të veprojë në përputhje me përcaktimet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Kuvendi nuk ka hapësirë për interpretimin e normave kushtetuese, pasi nuk është në pozitat e interpretuesit të parë dhe origjinal të tyre, për sa kohë që për çështjen konkrete është shprehur Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimmarrjen e saj ka konstatuar se mocioni i jo më pak se 1/10-ës së deputetëve plotëson kriteret juridiko-formale për vënien e saj në lëvizje nga Kuvendi, ndaj ky i fundit nuk ka pasur hapësirë për të vlerësuar sërish ato.

11.6. Kuvendi nuk ka vepruar në përputhje me Kushtetutën për sa kohë çështjen e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese ia ka nënshtuar vlerësimit të Këshillit për Legjislacionin dhe Këshillit për Mandatet, struktura në të cilat shumica parlamentare ka vënë në dyshim fuqinë detyruese të vendimit të Gjykatës, ka thirrur ekspert të jashtëm dhe, më pas, ka vlerësuar se çështja duhet t'i përcillet për votim seancës plenare, votim në të cilin gjente zbatim parimi i mandatit jodetyrues. Zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin konkret nuk është një procedurë e zakonshme parlamentare, por një procedurë për ekzekutimin e një detyrimi konkret të lindur prej tij, sikurse është ai për dërgimin asaj të çështjes së papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka të ngritur mbi mocionin e 1/10-ës së deputetëve.

11.7. Në kontekst të rrethanave të rastit dhe në raport me përcaktimet e nenit 66/a, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 në lidhje me afatin maksimal të paraqitjes asaj të kërkesës nga Kuvendi, konsideron të theksojë se shqyrtimi i çështjes nga Kuvendi duhet të bëhet me përparësi, për t'i hapur rrugë ushtrimit nga Gjykata të kompetencave të saj..... Detyrimin e Kuvendit të Shqipërisë për dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të mocionit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka.

12. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, përmes vendimit nr. 55, datë 10.07.2024, ka vendosur përfundimisht: **“3. Shfuqizimin e vendimit nr. 41/2024, datë 11.04.2024 “Për mosdërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese” të Kuvendit të Shqipërisë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. 4. Detyrimin e Kuvendit të Shqipërisë për dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të mocionit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka”.**

IV. DISKUTIMI, ANALIZA DHE ARSYETIMIT I EFEKTEVE TË VENDIMIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE NË KËSHILLIN PËR LEGJISLACIONIN

13. Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese u morë në shqyrtim nga Këshilli për Legjislacionin bazuar në nenin 132 të Kushtetutës dhe nëniti 87 të Rregullores së Kuvendit. Në mbledhjen e këtij Këshilli, u analizuan efektet e këtij vendimi dhe sesi Kuvendi duhet të reflektojë zbatimin e tij. Këshilli i Legjislacionit në mbledhjet e datës 27.08.2024 diskutoi rreth arsytimit të Gjykatës Kushtetuese dhe detyrimit që është përcaktuar në mënyrë të shprehur në dispozitivin e vendimit, jo thejshëm për shfuqizimin e vendimit nr. 41/2024 të Kuvendit të Shqipërisë, por edhe detyrimin konkret të shprehur për dërgimin për shqyrtim të mocionit të 1/10 për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka në Gjykatën Kushtetuese.

14. Këshilli vëren se Gjykata Kushtetuese, në vendimmarrjen e saj ka konstatuar se mocioni i jo më pak se 1/10-ës së deputetëve plotëson kriteret juridiko-formale për vënien e saj në lëvizje nga Kuvendi, ndaj ky i fundit nuk ka hapësirë për të vlerësuar sërish ato. Sipas Gjykatës Kushtetuese Kuvendi nuk ka vepruar në përputhje me Kushtetutën për sa kohë çështjen e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese ia ka nënshtruar vlerësimit të Këshillit për Legjislacionin dhe Këshillit për Mandatet, struktura në të cilat shumica parlamentare ka vënë në dyshim fuqinë detyruese të vendimit të Gjykatës, ka thirrur ekspert të jashtëm dhe, më pas, ka vlerësuar se çështja duhet t'i përcillet për votim seancës plenare, votim në të cilin gjente zbatim parimi i mandatit jodetyrues. Këshilli konstaton se Gjykata Kushtetuese është shprehur se zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin konkret nuk është një procedurë e zakonshme parlamentare, por një procedurë për ekzekutimin e një detyrimi konkret të lindur prej tij, sikurse është ai për dërgimin asaj të çështjes së papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka të ngritur mbi mocionin e 1/10-ës së deputetëve.

15. Këshilli gjithashtu vëren se Gjykata Kushtetuese është shprehur se procedura e vendimmarrjes së Kuvendit dhe votimi i deputetëve në atë rast, nuk mund të përlligjet me parimin e mandatit jodetyrues të deputetit, për shkak se zbatimi i vendimit të Gjykatës nuk është një çështje politike, rast në të cilin Kuvendi ka hapësirë vlerësimi dhe deputeti gëzon lirinë e zgjedhjes së qëndrimit përmes votimit sipas mandatit të lirë. Sipas arsytimit të Gjykatës Kushtetuese parimi kushtetues i mandatit të lirë të një deputeti nuk mund të kuptohet si liri absolute e tij, që nuk kufizohet nga Kushtetuta dhe ligjet, për të vepruar në një mënyrë të tillë që Kuvendi të mos jetë në gjendje të zbatojë kërkesat që burojnë nga Kushtetuta dhe të miratojë vendime të papajtueshme me të. Kjo liri në votim e deputetit u nënshtrohet kufizimeve që rrjedhin nga parimet e supremacisë së Kushtetutës, të shtetit të së drejtës dhe të kushtetutshmërisë, element i të cilave është edhe detyrueshmëria e zbatimit të vendimeve të Gjykatës. Në këtë kuptim, sipas Gjykatës Kushtetuese parimi i mandatit të lirë të deputetit nuk mund të shtrihet në çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në rastet kur ajo ka

përcaktuar për Kuvendin detyrime konkrete që nuk lënë hapësirë vlerësimi për mënyrën e zbatimit nga ana e tij.

16. Në këtë mënyrë, për anëtarët e Këshillit të Legjislacionit, në kuptim të neneve 124 dhe 132 të Kushtetutës, vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i detyrueshëm për zbatim dhe mënyra e vetme e zbatimit të tij është përmes një vendimmarrje të detyrueshme nga Kuvendi për të dërguar në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtim mocionin e 1/10 së deputetëve për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka.

NË PËRFUNDIM:

Këshilli për Legjislacionin, i mbledhur me datë 27.08.2024, ora 11.00, konstaton se:

1. Me vendimin nr. 55/2024 të Gjykatës Kushtetuese është zgjidhur një konflikt kompetencash midis 1/10 së deputetëve, anëtarë të pakicës parlamentare, dhe Kuvendit të Shqipërisë.

2. Vendimi nr. 41/2024, datë 11.04.2024 “Për mosdërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese” i Kuvendit të Shqipërisë, është shpallur si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar shprehimisht detyrimin e Kuvendit të Shqipërisë për dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të mocionit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes znj. Olta Xhaçka dhe për pasojë Kuvendi ka detyrimin që të votojë për dërgimin e këtij mocioni në Gjykatën Kushtetuese, si mënyra e vetme për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe mënyra e vetme e zgjidhjes së këtij konflikti kompetencash.

4. Parimi i mandatit të lirë të deputetit nuk mund të shtrihet në çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në rastet kur ajo ka përcaktuar për Kuvendin detyrime konkrete që nuk lënë hapësirë vlerësimi për mënyrën e zbatimit nga ana e tij.

5. Zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin konkret nuk është një procedurë e zakonshme parlamentare, por një procedurë për ekzekutimin e një detyrimi konkret të lindur prej tij, sikurse është ai për dërgimin asaj të çështjes së papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka të ngritur mbi mocionin e 1/10-ës së deputetëve.

PËR TË GJITHA ARSYET SI MË LART,

Në mbështetje të neneve 124 dhe 132 të Kushtetutës; nenit 81 të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë; si dhe neneve 14 dhe 87 të Rregullores së Kuvendit, Këshilli i Legjislacionit i paraqet këtë Raport Kryetares së Kuvendit,

DUKE REKOMANDUAR SA MË POSHTË:

Në përputhje me vendimin nr. 55/2024 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe me përcaktimin në vendim se: *“në kontekst të rrethanave të rastit dhe në raport me përcaktimet e nenit 66/a, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 në lidhje me afatin maksimal të paraqitjes asaj të kërkesës nga Kuvendi, konsideron të theksojë se shqyrtimi i çështjes nga Kuvendi duhet të bëhet me përparësi, për t'i hapur rrugë ushtrimit nga Gjykata të kompetencave të saj.”..... “Detyrimin e Kuvendit të Shqipërisë për dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të mocionit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka.”;*

MËNYRA E VETME PËR ZBATIMIN E KËTIJ VENDIMI TË GJYKATËS KUSHTETUESE ËSHTË NDJEKJA E PROCEDURËS PARLAMENTARE SI MË POSHTË:

1. Kryetarja e Kuvendi duhet të përfshijë në seancën më të parë plenare për vendimmarrje nga Kuvendi projektvendimin “Për dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të mocionit të jo më pak se 1/10 së deputetëve për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetes znj. Olta Xhaka”.
2. Kryetarja e Kuvendit duhet të informojë Kuvendin se duhet të vendosë dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të mocionit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaka, pa vonesa, për t’i hapur rrugë ushtrimit nga Gjykata të kompetencave të saj kushtetuese.
3. Kryetarja e Kuvendit duhet të informojë deputetët e Kuvendit të Shqipërisë se në këtë rast kanë detyrimin për të zbatuar Kushtetutën dhe ligjin, që detyrojnë vetëm votimin “PRO” projektvendimit “Për dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të mocionit të jo më pak se 1/10 së deputetëve për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetes znj. Olta Xhaka”, për shkak se deputetët e Kuvendit të Shqipërisë duhet të ekzekutojnë një detyrim konkret të lindur prej një vendimi të Gjykatës Kushtetuese.
4. Kryetarja e Kuvendit duhet të informojë Kuvendin për konstatimet dhe rekomandimet e dhëna në këtë opinion këshillimor nga anëtarët e Këshillit për Legjislacionin.

Një kopje e këtij raporti i dorëzohet Kryetares së Kuvendit, një kopje ruhet në Zyrën e Arkivës së Kuvendit, dhe një kopje i shpërndahet për dijeni deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë. Me dorëzimin e këtij Raporti, përgjegjësia e Këshillit për Legjislacionin sipas nenit 87 të Rregullores së Kuvendit konsiderohet e përmbushur.

Në mbledhjen e Këshillit për Legjislacionin u diskutua dhe morën pjesë anëtarët e Këshillit, sipas zbardhjes së bërë në procesverbalin e mbledhjes së datës 27.08.2024.

Me respekt,

KËSHILLI PËR LEGJISLACIONIN:

KRYETARE

DHURATA TYLI (ÇUPI)

ANËTARË:

GAZMENT BARDHI

SAIMIR KORRESHI

OERD BYLYKBASHI

ASLLAN DOGJANI

ANEKSI 1 – DEKLARATË PUBLIKE E GJYKATËS KUSHTETUESE, PËRMES KRYETARES SË GJYKATËS ZNJ. HOLTA ZAÇAJ

Tiranë, më 30.07.2024

NJOFTIM VENDIMMARRJEJE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në datat 21.06.2024 dhe 25.06.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen me kërkues jo më pak se 1/10 e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë dhe jo më pak se 1/5 e deputetëve të tij, me objekt:

1. *“Kundërshtimi i vendimit nr. 41/2024, datë 11.04.2024 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosdërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese për papajtueshmerinë me mandatin të deputetes Olta Xhacka” dhe deklarimi i këtij vendimi si papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.*
2. *Zgjidhja e konfliktit të kompetencave ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10 e deputetëve, duke përcaktuar mënyrën kushtetuese konkrete se si zgjidhet ky konflikt dhe se si ushtrohet e drejta kushtetuese e pakicës parlamentare (një të dhjetës së deputetëve) për të mos u penguar mocioni i tyre nga Kuvendi në kushtet e mosverifikimit të pengesave formale, në kushtet kur mazhoranca, me votim, ka vendosur moszbatimin e vendimit nr. 1, datë 23.01.2023 të Gjykatës Kushtetuese dhe kjo mund të ripërsëritet në të ardhmen.*
3. *Interpretimi përfundimtar i neneve 70, pikat 1 dhe 4, 73, pika 1, 132, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Shqyrtimi i çështjes me përparësi, për shkak të interesit të lartë publik që paraqet.”.*

Gjykata Kushtetuese, pasi shqyrtoi çështjen në seancë publike me pjesëmarrjen e palëve, sot më datë 10.07.2024, konstatoi se vendimi i saj nr. 1, datë 23.01.2023 nuk është ekzekutuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Gjykata vlerësoi se përmes vendimit nr. 41/2024, datë 11.04.2024, Kuvendi i Shqipërisë ka vënë në diskutim fuqinë detyruese të vendimit të saj, duke mos zbatuar nenin 132, pika 1, të Kushtetutës, i cili parashikon se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim.

Gjykata ritheksoi se vendimet e saj kanë efektet e forcës së ligjit. Asnjë organ nuk ka të drejtë t'i vërë ato në diskutim dhe aq më tepër të mos pranojë t'i zbatojë. Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të saj është i tillë që ju imponon të gjithë organeve shtetërore fuqinë detyruese të vendimit të saj. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit.

Gjykata theksoi se vendimi i saj që ka vendosur detyrimin e Kuvendit për të dërguar në Gjykatë mocionin e 1/10 së deputetëve për papajtueshmërinë e mandatin të deputetit, sipas nenit 70 të Kushtetutës, është i detyrueshëm për zbatim në respekt të nenit 132, pika 1, i Kushtetutës. kjo do të thotë se Kuvendi (deputetët e tij) duhet të votojnë në përputhje me urdhërimin e Gjykatës, pasi ky votim nuk është një

procedurë e zakonshme parlamentare dhe si e tillë nuk ka të bëjë me parimin e mandatit jodetyrues të deputetit, por është në kuadër të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës.

Për sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Gjykata, me shumicë votash, vendosi:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Zgjidhjen e konfliktit/mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10-ta e deputetëve.
3. Shfuqizimin e vendimit nr. 41/2024, datë 11.04.2024 “Për mosdërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese” të Kuvendit të Shqipërisë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
4. Detyrimin e Kuvendit të Shqipërisë për dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të mocionit mbi papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka.

Në kuadër të kësaj vendimmarrjeje, Gjykata thekson se Kuvendi mbart detyrimin për ekzekutimin pa vonesë të këtij vendimi.

Vendimi përfundimtar do të shpallet i arsyetuar brenda afateve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Rregullorja për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

*ANEKSI 2 – VENDIMI NR. 55, DATË 10.07.2024 I GJYKATËS KUSHTETUESE, BOTUAR NË
FLETOREN ZYRTARE NR. 139, DATË 07.08.2024*